

ABSTRAKT

Marrëveshja e Parisit për Klimën, është marrëveshje ndërkombëtare, ligjërish e obligueshme për ndryshimet klimatike, e cila për herë të parë bëri bashkë 197 shtete për të parandaluar ndryshimet klimatike. Punimi paraqet rëndësinë e Marrëveshjes së Parisit për Klimën dhe përgjegjësin e shteteve, si dhe analizon se çka përmban legjislacioni i Republikës së Kosovës për mbrojtjen e Klimës. Punimi është i bazuar në burimet zyrtare të Kombeve të Bashkuara, përfshirë këtu Konventën Kornizë për Ndryshime Klimatike, marrëveshjet pararendëse të cilat i kanë paraprirë Marrëveshjes së Parisit për Klimën, Raporteve të Panelit Ndërqeveritare për Ndryshimet Klimatike, të cilat argumentojnë më së miri nevojën për zbatimin e Marrëveshjes. Ndërsa përgjegjësit e shteteve për të përmbushur detyrimet e dala nga kjo marrëveshje, burojnë nga vete nënshkrim dhe ratifikimi i Marrëveshjes.

Në përgjithësi ky punim ka paraqitur disa nga sfidat dhe shembujt të cilat po e sfidojnë këtë Marrëveshje, siç janë kërcënimet e shteteve të pasura për t'u tërhequr nga kjo Marrëveshje dhe financimi i pamjaftueshëm nga shtete a pasura për arritjen e objektivave të synuara.